

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E PRIVATIZIMEVE
Drejtoria e Shoqerive Publike
Nr 23 Prot

Tirane me 9.1 1997

U R D H E R
Nr 4 date 9.01 1997

P E R
TRANSFERIMIN E AKSIONEVE NE SHOQERINE ANONIME
"GURI GELQEROR" ELBASAN

Ne baze te nenit 1 te Dekretit nr 1631 date 1.11.1996, miratuar me Ligjin nr 8158 date 7.11.1996 "Per miratimin me ndryshime te dekretit nr 1631 date 1.11.1996, Per disa ndryshime ne ligjin 7926 date 20.04.1995, Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare, ndryshuar me dekretin nr 1195 date 14.08.1995 dhe ligjin nr 8099 date 28.03.1996" me cilesine e aksionerit te vetem,

U r d h e r o j :

1. Te privatizohet nepermjet transferimit te aksioneve shoqeria anonime "Guri gelqeror" Elbasan, sipas Vendimit nr 837 date 09.12.1996 te Keshillit te Ministrave.
2. Transferimi i aksioneve te behet ne masen 70 %.
3. Transferimi i aksioneve ne perputhje me piken 2 te ketij urdhri te perfundoje brenda afateve ligjore ne fuqi.

MINISTRI
Dylber VRIONI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I MINISTRAVE
AGJENCIA KOMBETARE E PRIVATIZIMIT

AUTORIZIM TRANSFERIM AKSIONESH

MINISTRISE PRIVATIZIMEVE

TIRANE

Ne baze te nenit 22 te Ligjit Nr. 7512, date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te veprimtarive private te pavarura dhe privatizimin", Ligjit nr. 8159, date 7.11.1996, ne baze te urdherit te Ministrit te Privatizimit Nr. 4, date 09.01.1997 per shitjen e paketes se aksioneve te shoqerise anonime "Guri Gelqeror", Letan, Elbasan dhe ne baze te nenit 198 te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare", është realizuar shitja e aksioneve te kesaj shoqerie si me poshte:

1. Nje pakete prej 70% e aksioneve te shoqerise te zoteruara 100 % nga Ministri i Privatizimeve, ne baze te paragrafit te dyte te nenit 4 te Ligjit Nr. 7926 date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve Shteterore ne Shoqeri Tregetare" jane shpallur per publikim per shitje me date 15.01.1997.
2. Ne baze te dispozitave ligjore ne fuqi shitja ka perfunduar me date 11 Mars 1997.
3. Aksioneri i shpallur nga ankandi është sipas protokollit bashkengjitur.

DREJTORE E PERGJITHSHME

LINDITA XHILLARI

The image shows a circular official stamp of the Agency for Privatization in Tirane. The text around the perimeter of the stamp reads "REPUBLIKA E SHQIPERISE" at the top, "AGJENCIA KOMBETARE E PRIVATIZIMIT" on the left, and "TIRANE" at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania. Overlaid on the right side of the stamp is a handwritten signature in black ink.

Protokoll i Llogaritjes per ankandin

Agjencia Kombetare e Privatizimit

Data 23.04.1997


Emri i Shoqerise Aksionere

“GURI GELQEROR” LETAN, ELBASAN

Kapitali themeltar	100%	52.800.000 Leke
Pjesa e kapitalit qe shitet	70%	36.960.000 Leke
Vlera nominale e nje aksioni		1000 leke
Vlera totale e ankandit		90.000.000 leke
Vlera e aksionit te vendosur nga ankandi		2435,064935 leke
Numri i aksioneve te shitura		36960
Numri i aksionereve		1
Numri i Aksioneve qe mban Shteti		15840
Koeficienti i shitjes		2,4350649
<i>(Raporti i vleres se Aksionit e vendosur nga Ankandi me vleren nominale te Aksionit)</i>		

DREJTORE E PERGJITHSHME

LINDITA XHILLARI



Raport mbi shperndarjen e Aksioneve per Shoqerine:

Data 23.04.1997

"GURI GELQEROR" LETAN, ELBASAN

Numri i Autorizimit 596	Data 11 Mars 1997
Rrethi: TIRANE	
EMRI MBIEMRI "SEAMENT ALBANIA" Shpk perfaqesuar nga Mark BOURI	
Leke:	90.000.000
Vlera Nominale e Aksionit:	1000
Numri i Aksioneve:	36960
Numri i Pasaportes:	B 468072
Perqindja ne kapitalin e ndermarrjes	70%
<u>Adresa :</u> Bulevardi Deshmoret e Kombit, Nr. 72: TIRANE	




REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTER MIMOZA SHEHU

Nr. Regj. Nr. Kol.

8732

3771



Tirane, me 30.12.1999

AKB. Nr. 3838 Prot. 30.12.1999.

KONTRATE
PER SHITJEN (TRANSFERIMIN) E 16 % (GJASHTEMBEDHJETE PERQIND) TE
AKSIONEVE NGA AKSIONET QE SHITETI SHQIPTAR ZOTERON NE
"UNITED QUARRIES" SH.A. LETAN ELBASAN

Sot, me date 30 Dhjetor 1999 (njemije e nenteqind e nentcdhjete e nente), ditën e enjte në Agjensinë Kombëtare të Privatizimit Tirane, përpara meje noterit Mimoza Shehu, e Dhomes së Noterise Tirane u paraqiten palet dhe në prani të tyre hartohet kontrata e shitjes (transferimit) të 16 % (gjashtembedhjete për qind) të aksioneve të zotëruara nga Shteti Shqiptar në "United Quarries" Sh.A. Letan Elbasan,


te cilat rane dakord për sa vijon :

Neni 1 - Palet

- 1.1 *Palet shitesë:* Agjensia Kombëtare e Privatizimit Tirane e përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm i saj, Z. Qirjako Theodhori.
- 1.2 *Palet blerëse:* "Seament Albania" Sh.p.k., e njohur person juridik me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tirane Nr.6446, datë 23.9.1994 dhe vendimit Nr.5341 datë 02.05.1998 përfaqësohet nga Z. Jorge Jela lindur në Brazil me 15.06.1953 me nr pasaportë CJ 639476, me banim në Tirane, sipas procedurës së postqumës Nr.8339 Rep. Nr.2995 Kol. datë 16.12.1999.

Neni 2 - Objekti i kontrates

- 2.1 Objekt i kësaj kontrate është shitja (transferimi) e 16 % (gjashtembedhjete për qind) të aksioneve të zotëruara nga shteti në "United Quarries" Sh.a. Letan Elbasan me vlerë 25.600.000 leke (njetzet e pesë milion e gjashtëqind mijë), sipas Urdhrit të Ministrisë të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit Nr.498 datë 29.12.1999. Kapitali themeltar i shoqërisë në momentin e regjistrimit në Gjykatën e Rrethit Tirane me vendimin Nr.15067 datë 04.06.1995 të pasqyruar edhe në Akt themelimit dhe Statutin e Shoqërisë rezultonte me vlerë 160.000.000 leke (njëqind e gjashtëdhjetë milion) me aksioner të vetëm Ministrinë e Financave, me vlerë nominale të aksionit 1000 (njemije) leke dhe me objekt veprimtarie prodhim tregtim gure gëlqeror, ku sipas shkresë së Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit Nr.8529 Prot., datë 30.12.1999 në këtë kapital përfshihet trualli me sipërfaqe 25302 (njetzet e pesë mijë e tetëqind e dy) m² me vlerë 4.048.400 leke (katërmiljon e dyzetë



e tete mije e katerqind) dhe ndertesa me vlere 117.152.086 (njqind e shtatembdhjete milion e njqind e pesedhjete e dy mije e tetedhjete e gjashte) leke bazuar ne bilancin ushtrimor te vitit 1995 ne momentin e transformimit te shoqerise.

Neni 3 - Cmimi i shitjes


- 3.1 Cmimi i shitjes se 16 % (gjashtembdhjete perqind) te aksioneve te zoteruara nga shteti, ne shoqerine "United Quarries" Sh.A. Letan Elbasan ortakut "Seament Albania" Sh.p.k. eshte 25.600.000 (njqzete e pese milion e gjashteqind mije) leke, vlere e paguar plotesisht nga pala blerese ne Banken e Kursimeve, Dega Tirane, numri i llogarise 4302 (Dega e Thesarit) ne favor te Agjensise Kombetare te Privatizimit.
- 3.2 Pala shites deklaroi se ne favor te saj eshte derdhur e gjith shuma e percaktuar ne piken 3.1 te ketij neni para perpilimit te kesaj kontrate sipas urdherxhirimeve te jashtem leshuar nga Banka e Kursimeve Tirane me nr.0987549 date 30.12.1999 per shumen 381.926 (treqind e tetedhjete e nje mije e nenteqind e njqzete e gjashte) leke, Nr.0987552 date 30.12.1999 per shumen 4.698.000 (katemiljon e gjasheqind e nentedhjete e tete mije) leke, Nr.0987550 date 30.12.1999 per shumen 2.599.000 (dy milion e peseqind e nentedhjete e nente mije) leke, Nr.0987551 date 30.12.1999 per shumen 17.915.000 (shtatembdhjete milion e nenteqind e pesembdhjete mije) leke dhe sipas mandat arketimeve leshuar nga Banka e Kursimeve nr. 0511227 date 30 Dhjetor 1999 per shumen 1.074 (njemije e shtatedhjete e kater) leke dhe nr.0511228 date 30 Dhjetor 1999 per shumen 5.000 (pese mije) leke. Vlefte totale e paguar nga pala blerese eshte 25.600.000 (njqzete e pesemiljon e gjashteqind mije) leke.

Neni 4 - Kushtet e shitjes

- 4.1 Aksionet prej 16 % (gjashtembdhjete perqind) te zoteruara nga Shteti Shqiptar qe shiten jane pershkruar ne perputhje me dokumentacionin derguar Agjensise Kombetare te Privatizimit nga Ministria e Ekonomise Publike dhe Privatizimit me shkresat Nr 8523 Prot, date 29.12.1999, dhe Nr.8529 Prot., date 30.12.1999 perpara perpilimit te kesaj kontrate.
- 4.2 Pala blerese ka plotesuar te gjitha kushtet e percaktuara nga pala shites ne autorizimin Nr.3837 Prot, date 30.12.1999 (njemije e nenteqind e nentedhjete e nente) te Agjensise Kombetare te Privatizimit Tirane.
- 4.3 Pala blerese pas nenshkrimmit te kesaj kontrate, noterimit te saj dhe pas regjistrimit te aksioneve ne Qendren e Regjistrimit te Aksioneve, eshte pergjegjese per te gjitha detyrimet ligjore ndaj shtetit qe mund te lindin ne lidhje me keto aksione qe nga momenti i firmosjes se kesaj kontrate.
- 4.4 Pala shites garanton palen blerese per pronesine shtetore te 16 % (gjashtembdhjete perqind) te aksioneve objekt i kesaj kontrate , dhe se ato jane te lira nga cdo detyrim apo barre ligjore dhe pretendim i cdo personi te trete.
Pas firmosjes se kesaj kontrate dhe noterimit te saj, pronesia e 16 % (gjashtembdhjete perqind) te aksioneve transferohet nga ortaku shtetor tek ortaku jo shtetor "Seament Albania" Sh.p.k., ne perputhje me objektin e kesaj kontrate.

Neni 5 - Te drejtat dhe detyrimet e bleresit





- 
- 5.1 Bleresi pranon blerjen e 16 % (gjashtembdhjete perqind) te aksioneve te zoteruar nga shteti Shqiptar ne "United Quarries " Sh.A. Letan Elbasan me kerkesen drejtuar Agjencise Kombetare te Privatizimit date 30 Dhjetor 1999 nga "Seament Albania"Sh.p.k.
 - 5.2 Bleresi fiton te drejten e pronesise mbi 16 % (gjashtembdhjete perqind) te aksioneve te blera prej tij, pas firmosjes se kesaj kontrate ne perputhje me legjislacionin perkates.
 - 5.3 Bleresi eshte pergjegjes per te mbuluar te gjitha shpenzimet ligjore dhe te noterise ne lidhje me rregjistrimin e ketyre aksioneve.
 - 5.4 Bleresi eshte pergjegjes per transferimin e titullit te pronesise ne emer te vet.
 - 5.5 Shoqeria "Seament Albania" Sh.p.k. merr persiper detyrimin per zbatimin e akt marreveshjes se lidhur ndermjet Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit dhe "United Quarries " Sh.A.Letan Elbasan date 25.11.1999.
 - 5.6 Pas nenshkrimit te kesaj kontrate, brenda 30-diteve, ne baze te ligjit Nr. 7843, date 13.07.1994 "Per Regjistrimin e Pasurive te Paluajtshme", pala blerese eshte e detyruar te paraqitet ne Qendren e Regjistrimit te Aksioneve.
 - 5.7 Pala blerese pas nenshkrimit, noterizimit te kesaj kontrate dhe rregjistrimit ne Zyren e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Elbasan dhe ne Qendren e Regjistrimit te Aksioneve Tirane behet pronar i 16 % (gjashtembdhjete perqind) te aksioneve, objekt i kesaj kontrate,ne "United Quarries " Sh.A. Letan Elbasan, me seli ne Tirane me adrese :Bulevardi "Deshmoret e Kombit" Nr.72.

Neni 6 Te drejtat dhe detyrimet e shitesit.

- 6.1 Pala shitesese garanton bleresin per pronesine e plote dhe te ligjshme te Shtetit Shqiptar mbi 16 % (gjashtembdhjete perqind) te aksioneve te Sh.A. " United Quarries" Letan Elbasan te ofruara pales blerese.
- 6.2 Pala shitesese garanton palen blerese per perputhjen e kesaj kontrate me frymen e legjislacionit civil ne Republiken e Shqiperise, si dhe te drejtat ligjore te bleresit ne lidhje me pronesine objekt i kesaj kontrate, perballe organeve gjyqesore, ne rast kontestimi te kontrates , kur kjo i kerkohet nga pala blerese.

Neni 7- Baza ligjore per lidhjen e kontrates

- Kodi Civil i Republikes se Shqiperise;
- Ligji Nr. 7512, date 10.08.1991;
- Ligji Nr. 7638, date 19.11.1992;
- Ligji Nr.8237,date 01.09.1997.
- Ligji Nr.8334., date 23.04.1998
- VKM Nr. 446, date 09.07.1998;
- VKM Nr. 24, date 21.01.1999.
- VKM.Nr.328.,date 12.07.1999.
- Udhezimi Nr. 2, date 28.10.1999.
- Statuti i "United Quarries"Sh.A. Letan Elbasan
- Akt themelimi i "United Quarries"Sh.A. Letan Elbasan
- Aktmarreveshja e dates 25.11.1999 midis MEPP-se dhe "United Quarries"Sh.A. Letan Elbasan
- Urdheri i Ministrit te Ministrise se Ekonimise Publike dhe Privatizimit Nr.498., date 29.12.1999.



3

-Shkresa e MEPP-se Nr.8523 Prot., date 29.12.1999.

-Shkresa e MEPP-se Nr.8529 Prot., date 30.12.1999.

Neni 8 - Dokumentat ligjore qe i bashkengjiten kesaj kontrate

- 8.1.Urdheri Nr.498 date 29.12.1999 i Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit me nje flete,fotokopje e noterizuar.
- 8.2.Shkresa e Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit Nr.8523 Prot., date 29.12.1999 me nje flete, fotokopje e noterizuar.
- 8.3.Statuti i "United Quarries"Sh.A. Letan Elbasan.me pese flete fotokopje e noteuar i vertetuar nga Dhoma e Notereve Tirane Nr.179 Rep.,Nr.196 kol., date 27.06.1997 me pese flete fotokopje e noteuar.
- 8.4.Shkresa e Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit Nr.8529 Prot., date 30.12.1999 me dy flete,(fotokopje e noterizuar.). Letra e "Seament Albania"Sh.p.k, drejtuar Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit date 25.11.1999 me nje flete fotokopje e noterizuar.
- 8.5.Shkresa e "Seament Albania"Sh.p.k. drejtuar MEPP-se date 8 Dhjetor 1999 me nje flete fotokopje e noteruar.
- 8.6.Akt marreveshje e dates 25.11.1999 midis Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit dhe "United Quarries"Sh.A. Letan Elbasan.,me nje flete fotokopje e noterizuar.

Neni 9 - Te ndryshme

- 9.1.Kjo kontrate iu lexua gojarisht paleve. Kjo kontrate perbehet nga 4 faqe, me kerkesen e paleve perpilohet ne 5 (pese) kopje ne gjuhen shqipe. Nje kopje e kontrates qendron ne Zyren e Noteres. nje kopje ne arshiven e Agjensise Kombetare te Privatizimit nje kopje i dergohet Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit dhe 2 (dy) kopje pales blerese.
- 9.2.Pala shitesese pasi e kuptoi permbajtjen e gjeti sipas vullnetit te tij te lire e te plote, po keshtu pala blerese pasi e kuptoi permbajtjen qe ju be e njohur nga perkthyesi Z. P. Zubaj i njohur personalisht nga noterja e gjeti sipas vullnetit te tij te lire e te plote. Ne kete moment palet e nenshkruan kontraten ne pranine e noterit pa asnje pretendim. Une noteri, ne baze te Ligjit Nr. 7829, date 01.06.1994 "Per Noterine" si dhe legjislacionit perkates per transferimin e aksioneve ne shoqerite anonime e vertetoj ate sipas ligjit.

PALET KONTRATUESE

PALA SHITese

Agjencia Kombetare e Privatizimit

Qirjako Theodhori,
Qirjako Theodhori
Drejtor i Pergjithshem

I pranishem Perkthyesi



Z. P. Zubaj
Z. P. Zubaj

PALA BLERESE

"SEAMENT ALBANIA" Sh.p.k.

perfaqesuar nga

Jorge Jeha
Jorge Jeha



MR. TEL:
TEL: 271-2 11 1393
Murrisa



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT

DREJTORIA E PRIVATIZIMIT TE NDERMARRJEVE DHE SHOQERIVE TE VOGLA DHE TE MESME

Blvd. Dëshmorët e Kombit Nr.2
E-mail: postmaster@mepp.tirana.al
Internet: HTTP://WWW.MEPP.GOV.AL

Tel : 355 42 27281
Fax : 355 42 22471

URDHER

Nr 498 Date ^{29.12.} 1999

PER
TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TE SHOQERISE ANONIME "UNITET
QUARRIES" LETAN ELBASAN


Ne baze te nenit 2 te Ligjit Nr.8237 date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926 date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shtetore ne shoden tregtare" me cilesine e zoteruesit te 30% te aksioneve te shoqerise, te Ligjit Nr.8334 date 23.04.1998 "Per privatizimin e shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jostrategjik", te V.K.M. Nr.446 date 09.07.1998 "Per procedurat e privatizimit me ankand te paketave shtetore te aksioneve te shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jostrategjik", te V.K.M. Nr.24 date 21.01.1999 "Per nje shtese ne V.K.M. Nr. 446 date 09.07.1998, V.K.M. Nr.328 date 12.07.1999 "Per disa ndryshime ne V.K.M. Nr.446 date 9.7.1998, dhe nenit 11 te statutit te "Unitet Quarries" sh.a Letan Elbasan

Urdheroj:

- 1- Te transferohen aksionet ne masen 16% , me vliere 25.600.000 leke nga paketa e aksioneve te zoteruara nga shteti ne shoqerine anonime "Unitet Quarries" Sh.A Elbasan, e cila i ofrohet ortakut pa ankand ne leke , sipas V.K.M. Nr.24 date 21.01.1999.
- 2-Transferimi i aksioneve sipas pikes 1 te ketij urdheri te perfundoje brenda afateve ligjore ne fuqi.
- 3- Urdheri Nr.12 date 14.10.1998 shfuqizohet.

REP. SHQIPERISË
DHOMA NOTEREVE TIRANE
VERT. FOTOKOPJA E NJEJTE
ME ORIGINALIN U PAROJTI
30.11.99

[Handwritten signature]





REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E EKONOMISE PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT

DREJTORIA E PRIVATIZIMIT TE NDERMARRJEVE E SHOQERIVE TE VOGLA DHE TE MESME

Blvd. Dëshmoret e Kombit Nr.2
E-mail: postmaster@mepp.tirana.al
Internet: HTTP://WWW.MEPP.GOV.AL

Tel: 355 - 42 6795
Fax: 355 - 42 25154

Nr. _____ Prot.

Tirane, me2001

URDHER

Nr. 504 date 22.10 2001

PER


TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TE SHOQERISE ANONIME "UNITET QUARRIES " LETAN ELBASAN


Ne baze te nenit 2 te Ligjit Nr.8237, date 1.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" ndryshuar me akte te tjera ligjore, ligjit Nr.8334 date 23.4.1998 "Per privatizimin e shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jo strategjike", dhe ne zbatim te vendimit Nr.119 date 18.3.2000 te Keshillit te Ministrave "Per procedurat e privatizimit me ankand te paketave shteterore te aksioneve te shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jo strategjike" , me cilesine e zoteruesit te aksioneve te shoqerise :

Urdheroj :

1-Te transferohet paketa e aksioneve per ish pronaret e truallit te shoqerise anonime "Unitet Quarries " Letan Elbasan, ne masen 0,90600000 % te kapitalit te shoqerise te regjistruar ne Gjykate, me vlere 1.449.600 leke, qe i pergjigjet numrit te aksioneve nga 1-1.449,6.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.





United Quarries - Sh.A.

Elbasan
Tirane

Tel & Fax: 00 355 545 2809
Tel: 00 355 42 439 34/6/7
Fax: 00 355 42 43935
E-Mail: seament@icc.al.eu.org.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NOTER HALIM ISLAMI

Nr. 1712 rep.

Nr. 191 kol.



**VENDIME TE MBLEDHJES SE
ASAMBLESE SE ZAKONSHME E TE JASHTEZAKONSHME TE
AKSIONAREVE TE SHOQERISE
UNITED QUARRIES SH.A.**

Me 05 Tetor 2000, asambleja e shoqerise United Quarries Sh.A. vendosi mbi rendin e dites ne vijim:

Ne cilesine e asamblese se zakonshme:

1. Emerimi i eksperteve kontabel per vitin 2000 ;

Ne cilesine e asamblese se jashtezakonshme:

1. Transferimi i aksioneve te aksionarit Shteti Shqiptar;
2. Ndryshimi i neneve perkatese te statutit te shoqerise;
3. Te ndryshme.

Ne lidhje me piken e pare, ne cilesine e asamblese se zakonshme, vendoset unanimisht emerimi ne cilesine e eksperteve kontabel per rivleresimin dhe rishikimin e aktivitetit financiar per vitin 2000 te Znj. Mimoza Sula dhe Znj. Diana Golemi.

Ne cilesine e asamblese se jashtezakonshme, aksioneret ne unanimitet vendosin per sa me poshte:

1. Ne lidhje me piken e pare te rendit te dites asambleja unanimisht vendosi:

Shteti Shqiptar i perfaqesuar nga Ministria e Ekonomise Publike dhe Privatizimit, zoteror ne kapitalin e shoqerise United Quarries Sh.A. 22.400 (njezete e dy mije e katerqind) aksioneve qe perbejne 14% te kapitalit te shoqerise. Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, Shteti Shqiptar ka vendosur te privatizojte kete pakete aksionesh duke ia shitur punonjesve te shoqerise dhe ish-pronareve te truallit ku ndodhen asetet e shoqerise.

Aksionari Seament Albania Shpk. jep pelqimin e tij te parevokueshem per shitjen e 22.400 (njezete e dy mije e katerqind) aksioneve qe perbejne 14% te kapitalit te shoqerise qe Shteti Shqiptar i perfaqesuar nga Ministria e Ekonomise Publike dhe Privatizimit, zoteror ne kapitalin e shoqerise Elbasan Cement Factory Sh.A., tek punonjesit e shoqerise dhe ish-pronaret e truallit ku ndodhen asetet e shoqerise. Gjithashtu aksionari Seament Albania Shpk. heq dore ne menyre te parevokueshme nga e drejta e parablerjes se ketyre aksioneve per kete shitje nga Shteti Shqiptar tek punonjesit e shoqerise dhe ish-pronaret e truallit ku ndodhen asetet e shoqerise .


2. Ne lidhje me piken e dyte te rendit te dites me propozim te aksionarit Seament Albania Shpk. dhe ne vijim te marreveshjes se arritur me aksionarin shteteror, asambleja unanimisht vendosi te modifikojte paragrafin e pare te nenit 11 te statutit te shoqerise si me poshte vijon:

“Aksionet mund t’u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri ose aksionareve te shoqerise, vetem me miratimin e Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionareve te shoqerise ne baze te rregullave te percaktuara ne ligjin shqiptar per shoqerite tregtare nr. 7638 dhe statutin e shoqerise.”

Paragrafet e tjere te nenit 11 do te mbeten te pandryshuar.

Ky akt perpilohet ne 5 (pese) kopje dhe nenshkruhet ne prani te Noterit Halim Islami nga perfaqesuesit e aksionereve te shoqerise: aksioneri Shteti Shqiptar i perfaqesuar nga Z. Bashkim Vladi me autorizimin e Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit, nr. 6301/2 protokolli date 25.09.2000 dhe aksioneri Seament Albania Shpk., i perfaqesuar nga Z. Charles Bouri.

BASHKIM VLADI



HALIM ISLAMI



CHARLES BOURI

